



**Kolegji AAB**

CILËSI. LEADERSHIP. SUKSESI!

# **Rregullore për Grante**



BPrAL - PPOHE  
**Kolegji AAB**

**KOLEGJI AAB**  
**AAB COLLEGE**  
Prishtinë

Nr. 1770/17 data: 12.07.2017

# **RREGULLORE PËR GRANTE**

Në bazë të nenit 38 të Statutit, Senati i Kolegjit AAB, në mbledhjen e mbajtur me datën 23.06.2017 miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR GRANTE**

### **Dispozita të Përgjithshme**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve për përfitim të granteve për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, simpoziume, kongrese, drejtime panelesh apo mbajtje ligjërata si dhe publikime.

#### **Neni 2 Kategoritë e shpenzimeve që mund të financohen dhe limiti financiar**

- a. Për pjesëmarrje në konferencë, simpozium, kongres, 200-350 euro;
- b. Shpenzimet e publikimit, 200-500 euro:
  - në revistat e ranguara (Scopus, Thomson Reuters) sipas fushave, nga 1-100/ 500 €
  - në revistat e ranguara nga 101-500 / 300 €
  - në revistat e ranguara nga 501-1000/ 200 €

#### **Neni 3 Kriteret për aplikim**

Kriteret për aplikim janë:

1. të jetë staf i brendshëm i AAB-së;
2. të dëshmojë miratimin e abstraktit (Acceptance Letter), apo ftesë për ligjëratë;
3. përkatësinë (affiliation) në abstrakt apo në letrën e pranimi, ta ketë AAB-në;
4. të jetë autor i parë;
5. konferenca të jetë e organizuar në ndonjërin nga vendet e BE-së, ose
6. organizatori i konferencës, qoftë si universitet apo për nga fusha e studimit/subjekti, të jetë në listën e 1000 universiteteve më të mira të botës (sipas matjeve të QS Top Universities, Times Higher Education apo Shangai Ranking), apo të ndonjë asociacioni të njohur ndërkombëtarisht në një profil të caktuar, si psh. ISA, IEEE, ESA etj.
7. Profesori nuk mund të aplikojë për më shumë se një grant nga AAB-ja brenda vitit kalendarik;

#### **Neni 4**

##### **Komisioni qendror për grante**

1. Komisioni qendror për grante përbëhet nga 3 anëtarë me të drejtë vote dhe ata janë:
  - a. Prorektori për shkencë, kryesues i komisionit
  - b. Dekani i Fakultetit përkatës dhe
  - c. Prorektori për financa
2. Prorektori për shkencë dhe prorektori për financa janë anëtarë të përhershëm të komisionit, ndërsa dekani i fakultetit ndërrohet sipas kërkesave që vinë nga profesorët dhe fusha e studimit.
3. Komisioni qendror për grante vendimet i merr me shumicë votash.
4. Vendimi i komisionit duhet në të gjitha rastet t'i përgjigjet kërkesës por që nuk nënkupton edhe miratimin e plotë të sajë.
5. Kërkesa mund të miratohet, miratohet pjesërisht dhe refuzohet. Në rastet kur miratohet ose miratohet pjesërisht, duhet të ceket edhe shuma e grantit që i ndahet profesorit.
6. Në rastet kur kërkesa refuzohet plotësisht, atëherë vendimi i komisionit duhet të jetë i arsyetuar.
7. Komisioni qendror obligohet që brenda tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të marrë vendimin përfundimtar, ose nëse i nevojiten informata shtesë për revistën, konferencën shkencore etj, atëherë tri dite nga pranimi i informatës së fundit.

#### **Neni 5**

Komisioni qendror për grante do të bëjë përpilimin e të gjithë formularëve të nevojshëm dhe do t'i miratoj të njëjtit dhe do t'i shqyrtoj vetëm ato aplikacione që bëhen sipas këtyre formularëve.

#### **Neni 6**

Vetëm pas sigurimit të pëlqimit nga Komisioni qendror për grante, munden njësitë akademike të aplikojnë për grante të jashtme.

#### **Neni 7**

Komisioni qendror për grante themelon një bazë të të dhënave në të cilën do të evidentohen të gjitha grantet e aprovuara, aprovuara pjesërisht dhe ato të refuzuara.

#### **Dispozitat Kalimtare**

#### **Neni 8**

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien ndesh me dispozitat e Statutit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

#### **Neni 9**


Ndryshimi i kësaj rregullore mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të saj.

**Neni 10**

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit të saj nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori.

Kryesuesi i Senatit

Dr. Lulzim Tafa, Rektor



Prishtinë 2017

